

LIGJ
Nr.10 487, datë 5.12.2011

PËR BUXHETIN E VITIT 2012
(Ndryshuar me Aktin Normativ nr. 5, datë 26.09. 2012)

(I përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 158 të Kushtetutës, si dhe të nenit 30 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
BUXHETI

Neni 1

Buxheti për vitin 2012 është:

Të ardhurat	355 759	milione lekë;
Shpenzimet	396 922	milione lekë;
Deficiti	41 163	milione lekë.

Ai përbëhet nga Buxheti i Shtetit, buxheti vendor dhe fondet speciale: sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe kompensimi i pronarëve.

Neni 2

Buxheti i Shtetit për vitin 2012 është:

Të ardhurat	281 622	milione lekë;
Shpenzimet	322 785	milione lekë;
Deficiti	41 163	milione lekë.

Neni 3

Buxheti vendor për vitin 2012 është:

Të ardhurat	29 503	milione lekë;
-------------	--------	---------------

Nga të cilat:

Granti i pakushtëzuar nga buxheti qendror	13 876	milione lekë;
Të ardhurat nga taksat e ndara	1 003	milione lekë;
Shpenzimet	29 503	milione lekë.

Neni 4

Buxheti i sigurimeve shoqërore për vitin 2012 është:

1. Skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror

Të ardhurat, gjithsej 84 360 milionë lekë;

Nga të cilat:

- kontributet	51 287	milionë lekë;
- transferimet nga Buxheti i Shtetit	33 073	milionë lekë;
Shpenzimet	84 360	milionë lekë.

Paga minimale, për efekt të pagesës së kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, përcaktohet nga Këshilli i Ministrave dhe ndryshon sa herë që rriten pagat dhe pensionet. Këshilli i Ministrave ka të drejtë të përcaktojë një kontribut të veçantë minimal për personat e vetëpunësuar në bujqësi dhe për kategoritë specifike të personave të vetëpunësuar. Diferenca ndërmjet kontributeve të veçanta me kontributin minimal mbulohet nga transfertat e Buxhetit të Shtetit, por jo më shumë se kufijtë e transfertave të përcaktuara në këtë ligj. Për vitin 2012, teprica e të ardhurave, sipas degëve të sigurimit shoqëror, përdoret për mbulimin e deficitit të degës së pensioneve.

2. Skema e sigurimit suplementar

Të ardhurat, gjithsej 5 405 milionë lekë;

Nga të cilat:

- kontributet	290	milionë lekë;
- transferimet nga Buxheti i Shtetit	5 115	milionë lekë;
Shpenzimet	5 405	milionë lekë.

Neni 5

Buxheti i sigurimeve shëndetësore për vitin 2012 është:

Të ardhurat, gjithsej 28 934 milionë lekë;

Nga të cilat:

- kontributet dhe të tjera	6 436	milionë lekë;
- transferimet nga Buxheti i Shtetit	22 498	milionë lekë;
Shpenzimet	28 934	milionë lekë.

Fondi për shërbimin spitalor jepet me hollësi dhe përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 6

Buxheti i fondit për kompensimin në vlerë të pronarëve për vitin 2012 është:

Të ardhurat, gjithsej 1 800 milionë lekë;

Nga të cilat:

- të ardhura të tjera	1 500	milionë lekë;
- transferimet nga Buxheti i Shtetit	300	milionë lekë;
Shpenzimet	1 800	milionë lekë.

Neni 7

Përdorimi dhe investimi i fondit rezervë të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore bëhen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

KREU II

BURIMET PËR MBËSHTETJEN E SHPENZIMEVE TË BUXHETIT TË SHETIT

Neni 8

Të ardhurat e Buxhetit të Shtetit, sipas grupeve kryesore, janë:

Grantet	9 843	milione lekë;
Të ardhurat tatimore	251 168	milione lekë;
Të ardhurat jotatimore	20 611	milione lekë.

Neni 9

Kufiri i financimit të deficitit të Buxhetit të Shtetit nga burime të brendshme dhe të huaja është 41 163 milionë lekë, nga i cili 300 milionë lekë financohen nga të ardhurat e privatizimit. Në rast mosrealizimi të të ardhurave të buxhetit dhe të të ardhurave nga privatizimi, huamarrja totale për financimin e deficitit prej 40 863 milionë lekësh nuk ndryshon. Këshilli i Ministrave merr masa për kompensimin e diferencave nga burime suplementare ose nga shkurtimi i shpenzimeve.

Çdo e ardhur nga privatizimi, e arkëtuar mbi shumën e parashikuar në këtë ligj, përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave për rritjen e kufirit të shpenzimeve për investime dhe uljen e huamarrjes, e cila, automatikisht, rrit kufirin e deficitit të Buxhetit të Shtetit, të përcaktuar në nenet 1 dhe 2 të këtij ligji.

KREU III

SHPENZIMET E BUXHETIT TË SHETIT

Neni 10

Shpenzimet e Buxhetit të Shtetit, sipas grupeve kryesore, janë:

Shpenzimet korrente	245 752	milione lekë;
Shpenzimet kapitale	69 872	milione lekë;
Fondi rezervë	2 000	milione lekë.
Fondi i kontingjencës për ruajtjen e deficitit	2 661	milione lekë;
Fondi për rritjen e pagave dhe pensione	2 500	milione lekë.

Kufiri i shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion, në nivel programi, është sipas tabelës 1, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Këshilli i Ministrave vendos norma dhe standarde financiare për shpenzimet publike, të cilat janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

Neni 11

Numri i përgjithshëm i punonjësve në organikë është 88 640 veta. Numri maksimal i punonjësve, i dhënë me hollësi për çdo ministri dhe institucion qendror, është sipas tabelës 1/1, që i

bashkëlidhet këtij ligji. Këshilli i Ministrave mund të rialokojë numrin e punonjësve ndërmjet institucioneve të përmendura në tabelën 1/1, në rastin e ristrukturimit të institucioneve ekzistuese apo krijimit të institucioneve të reja. Numri rezervë, i parashikuar në tabelën 1/1, përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave vetëm për institucione të reja të krijuara me ligj. Këshilli i Ministrave përcakton numrin maksimal të punonjësve me kontratë të përkohshme për çdo ministri dhe institucion qendror. Fondi i veçantë i institucioneve buxhetore prej 1 931 milionë lekësh shpërndahet dhe përdoret me miratimin e Ministrit të Financave dhe sipas procedurave që përcaktohen me udhëzim të tij.

Për vitin 2012 nuk do të miratohet asnjë ndryshim në strukturat organike të njësive të qeverisjes qendrore me efekte financiare shtesë në koston e personelit, të përlogaritur sipas strukturës së miratuar, me përjashtim të institucioneve të reja të krijuara me ligj.

Neni 12

Paga e Presidentit të Republikës është 255 000 lekë në muaj dhe rritet sipas përcaktimeve të Këshillit të Ministrave për rritjen e përgjithshme të pagave.

Neni 13

Fondi rezervë i Këshillit të Ministrave prej 2 000 milionë lekësh përdoret për raste të paparashikuara të institucioneve buxhetore. Fondi i kontingjencës për ruajtjen e deficitit prej 2 661 milionë lekësh përdoret me vendime të Këshillit të Ministrave. Fondi për rritjen e pagave e të pensioneve prej 2 500 milionë lekësh shpërndahet nga Ministri i Financave sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave.

Neni 14

Buxheti i pushtetit gjyqësor administrohet nga Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, në mbështetje të ligjit nr. 8363 datë 1.7.1998. Bordi i kësaj zyre bën shpërndarjen e fondeve buxhetore nga programi i buxhetit gjyqësor, sipas tri niveleve të këtij pushteti.

Neni 15

(Ndryshuar fjalia e fundit e paragrafit të parë me Aktin Normativ nr. 5, datë 26.9.2012)

Transfertat e pakushtëzuara,¹ që buxheti qendror ia transferon pushtetit vendor, përfshijnë fondet për përballimin e veprimtarive dhe të funksioneve që përcaktohen në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Shuma e transfertës së pakushtëzuar, për çdo njësi të pushtetit vendor paraqitet në kolonën e parë të tabelës 3, që i bashkëlidhet këtij ligji. Në kolonën 2 të tabelës 3 paraqitet subvencioni për energji elektrike për furnizimin me ujë të pijshëm.

Fondi i kompensimit nga totali i transfertës së pakushtëzuar përdoret nga Ministria e Financave, në përputhje me kriteret e përcaktuara në aneksin 2, që i bashkëlidhet këtij ligji. Fondet për zhvillimin e rajoneve shpërndahen sipas aneksit 3, që i bashkëlidhet këtij ligji.

¹ Akti Normativ nr. 5 datë 26.9.2021, botuar në F.Z. nr. 128, datë 2.10.2012 në nenin 2 shprehet: “*Transferta e pakushtëzuar dhe subvencioni për energji elektrike për furnizimin me ujë të pijshëm, të papërdorura gjatë vitit buxhetor, trashëgohen në vitit buxhetor pasardhës.*”

Fondet për konviktet e arsimit parauniversitar shpërndahen sipas aneksit 4, që i bashkëlidhet këtij ligji. Fondet për administrimin e qendrave të shërbimit social shpërndahen sipas aneksit 5, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Bashkitë, që kanë deri në 20 000 banorë, përdorin deri në 25 për qind të transfertës së pakushtëzuar për koston e personelit administrativ.

Bashkitë, që kanë 20 001 - 50 000 banorë, përdorin deri në 20 për qind të transfertës së pakushtëzuar për koston e personelit administrativ.

Bashkitë, që kanë mbi 50 001 banorë, përdorin deri në 15 për qind të transfertës së pakushtëzuar për koston e personelit administrativ.

Komunat, që kanë deri në 3 000 banorë, përdorin deri në 45 për qind të transfertës së pakushtëzuar për koston e personelit administrativ.

Komunat, që kanë 3 001 - 10 000 banorë, përdorin deri në 40 për qind të transfertës së pakushtëzuar për koston e personelit administrativ.

Komunat, që kanë 10 001 - 15 000 banorë, përdorin deri në 35 për qind të transfertës së pakushtëzuar për koston e personelit administrativ.

Komunat, që kanë mbi 15 001 banorë, përdorin deri në 30 për qind të transfertës së pakushtëzuar për koston e personelit administrativ.

Këshillat e qarqeve përdorin deri në 50 për qind të transfertës së pakushtëzuar për koston e personelit administrativ.

Komunat dhe bashkitë përdorin jo më pak se 10 për qind të transfertës së pakushtëzuar për mbështetjen e pemëtarisë dhe gjelbërimit. Rregullat, procedurat e skema e financimit dhe e bashkëfinancimit miratohen me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

Këshilli i Ministrave, nga fondet në dispozicion të tij, rimbursion koston e pajisjeve fiskale, në përputhje me kërkesat e njësisë të qeverisjes vendore. Rregullat dhe procedurat e rimbursimit përcaktohen me urdhër të Ministrit të Financave.

Pjesa e të ardhurave nga renta minerare, që u takon njësisë të qeverisjes vendore, shpërndahet nga Ministria e Financave, sipas kërkesave të njësisë të qeverisjes vendore, në përputhje me procedurat ligjore dhe formulën e dhënë në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Fondet që, sipas këtij neni, u vihen në dispozicion njësisë të qeverisjes vendore, fondet e tjera që, me akte të tjera ligjore dhe nënligjore, u kalojnë njësisë të qeverisjes vendore, si dhe me vendimet e këshillave komunalë, bashkiakë dhe të këshillave të qarqeve, që kanë lidhje me përdorimin e fondeve buxhetore, bëhen publike.

Neni 16

Fondet e Buxhetit të Shtetit për arsimin e lartë shpërndahen në formën e grantit. Formula për ndarjen e grantit jepet në aneksin 6, që i bashkëlidhet këtij ligji. Kriteret për përdorimin e granteve konkurruese në arsimin e lartë janë të njëjta me ato të përcaktuara në aneksin 3, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 17

Kufiri i shpenzimeve, sipas tabelës I, që i bashkëlidhet këtij ligji, mund të rishpërndahet gjatë vitit ndërmjet programeve brenda të njëjtit institucion buxhetor apo ndërmjet programeve të institucioneve të ndryshme nga Këshilli i Ministrave, deri në masën 10 për qind të shumës së përgjithshme të shpenzimeve korrente apo shpenzimeve të përgjithshme kapitale, duke ruajtur totalin e shpenzimeve korrente dhe kapitale. Bëjnë përjashtim nga ky kufi fondet e shpërndara nga Komiteti

i Zhvillimit të Rajoneve.

Neni 18

(Ndryshuar paragrafi i parë me Aktin Normativ nr. 5, datë 26.9.2012)

Kufiri për rritjen vjetore të totalit ekzistues të borxhit të shtetit dhe atij të garantuar në dobi të palëve të treta përfituese, për vitin 2012, bëhet 79 965 milionë lekë.

1. Për huamarrjen vjetore neto për mbështetjen buxhetore, deri në 18 515 milionë lekë.
2. Për huamarrjen neto për financimin e projekteve të huaja, deri në 46 000 milionë lekë.
3. Për rritjen vjetore të garancive të shtetit, në dobi të palëve të treta përfituese, deri 13,700 milionë lekë
4. Kufiri për rritjen vjetore të stokut të borxhit, si rezultat i riskedulimit të borxheve të vjetra, të huaja të papaguara, deri në 1 750 milionë lekë.

Neni 19

Ngarkohet Ministria e Financave të nxjerrë udhëzime për zbatimin e këtij ligji.

Neni 20

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2012.

Shpallur me dekretin nr.7185, datë 14.12.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi